

**Komentet e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së, Ambasadori Eugen Wollfarth, për  
median gjatë vizitës në Elbasan**

17 prill 2012

**Gazetari: A do të realizojë Prezenca e OSBE-së ndonjë projekt konkret bashkëpunimi me Bashkinë e Elbasanit?**

**Ambasadori Wollfarth:** Ne kemi një bashkëpunim të rregullt. Më pëlqen të vij në Elbasan dhe Kryetari i Bashkisë Sejдини e di këtë. Për gjithë Shqipërinë në fakt, për ne si OSBE është shumë e rëndësishme që të ketë marrëdhënie të ngushta me qeveritë vendore dhe sidomos Elbasani, duke qenë qendra apo zemra e Shqipërisë, është një vend i shkëlqyer për ta bërë këtë. Elbasani gjendet në qendër të vendit, është një qytet me tradita të shquara, është një vend ku ne shohim se si mund të kontribuojmë më shumë për të bërë më të mirën. Qeveria vendore ka një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të qytetarëve. Qytetarët e zgjedhin drejtpërdrejt Kryetarin e tyre të Bashkisë, siç vepruan edhe në zgjedhjet e fundit vendore. Ja pse është shumë e rëndësishme për ne që të kemi një marrëdhënie të ngushtë me Kryetarët e Bashkive, sidomos me Kryetarin tuaj të nderuar Sejдини, për të ndërtuar një lloj ure lidhëse mes nivelit kombëtar dhe atij vendor. Siç e thashë edhe më sipër më pëlqen shumë të vij në Elbasan, në mos gaboj kjo është vizita ime e katërt këtu, por sigurisht jo e fundit. Një nga arsytet e vizitës sime sot, siç do ta shihni vetë më vonë, është se do të flas në Universitet.

**Gazetari: Një pyetje për reformën zgjedhore, a ka një ngërç?**

**Ambasadori Wollfarth:** Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore është duke punuar, deri tani nuk shoh ndonjë shenjë ngërçi. Është shumë e rëndësishme që kjo detyrë e komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore të realizohet në Kuvend dhe bashkëkryetarët e këtij komisioni deri tani po bëjnë një punë të shkëlqyer. Të gjithë anëtarët e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore janë duke kontribuar në nivel ekspertësh dhe gjatë kësaj jave do të kemi një vizitë tjetër të ekspertëve të OSBE/ODIHR-it. Kështu që jam i bindur se do të ketë progres.

**Pyetje: Ambasadori amerikan në Shqipëri Z. Arvizu ka folur për një fillim të vështirë, duke pasur parasysh situatën politike disa muaj përpara zgjedhjeve presidenciale, si dhe një vit përpara zgjedhjeve të përgjithshme, të cilat do të mbahen në vitin 2013. Ai u shpreh se polemikat mes politikanëve shqiptarë janë bërë shkak për vonesën e marrjes nga Shqipëria të statusit kandidat për në Bashkimin Evropian dhe shtoi se ne jemi këtu së bashku me OSBE/ODIHR-in për të ndihmuar në kapërcimin e këtyre pengesave. Ç'mund të na thoni për këtë?**

**Ambasadori Wollfarth:** Gjëja më e rëndësishme mes politikanëve dhe popullit, popullit dhe politikanëve, si dhe mes vetë politikanëve, është që të ndërtojnë besimin e ndërsjellë mes tyre. Zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë caktuar për në vitin 2013, këtë verë është caktuar të mbahet zgjedhja e Presidentit të Republikës dhe është shumë e rëndësishme për

vendin, por edhe për mbajtësin e ardhshëm të këtij posti, që të zhvillohet një proces dinjitoz. Tani është koha për të kërkuar kandidatë të mirë, ndërsa për sa i përket mënyrës se si do të mbahet votimi në Kuvend, mendoj se Kushtetuta flet qartë në lidhje me këtë çështje. Sigurisht shpresoj se do të zhvillohet një proces dinjitoz, sepse vendi dhe qytetarët e tij e meritojnë këtë.

**Gazetari: Pra, ju mendoni se ata do të ndjekin kushteturen në këtë rast? Se do të kemi një votim në Kuvend, dhe se në të do të zgjidhet një President konsensual?**

**Ambasadori Wollfarth:** Kushtetuta mbetet në fuqi. Nuk kam ndonjë të dhënë që të thotë të kundërtën, pra, nuk ekziston asnjë mënyrë për ta anashkaluar atë.